



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUS i Lëndës Metodologjia e hartimit të diplomës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Metodologjia e hulumtimit dhe shkruarjes së diplomës
Niveli:	BSc.
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semestri VI)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Përmes Metodes Kërkimore dhe Shkruarjes së diplomes mundësohet krijimi i një vizioni të integruar për metodat kërkimore në biznes dhe komponentet e tyre, analizimi dhe kuptimi i lidhjeve midis metodave dhe teknikave kërkimore në biznes, analiza e të dhënave, nxjerrja e përfundimeve shkencore, ngritja dhe përdorja e teorive për sqarimin dhe parashikimin e sjelljes së trendeve ekonomike në firmën e biznesit apo në institucionin financiar, dhe reagimi i grupeve të interesit. Studimi i metodologjisë kërkimore në biznes paraqet një sfidë të mirëfilltë për qasje moderne zgjidhjes së problemeve të parashikimit, planifikimit dhe përdorimit të burimeve në organizatë. . Kjo realizohet përmes zhvillimit të analizave me teknikën e studimit të rasteve ku struktura e diskutimit dhe vetë zhvillimi i tij manaxhohet prej studenteve duke i aftësuar dhe pajisur ata me shumën e njohuri dhe shkathsi, që mund të fitohen vetëm përmes përballjes me situatat reale organizative.
Qëllimet e lëndës:	• Të përshkruajë dhe shpjegojë çfarë janë kërkimet në biznes dhe se si ato ndryshojnë nga sistemi i mbështetjes së vendimeve të biznesit dhe sistemet e inteligjencës në biznes. • Të shpjegojë trendet që ndikojnë kërkimet

	në biznes dhe hierarkia në zhvillimin e vendim-marrjës në biznes. • Të shpjegojë dallimin ndërmjet kërkimit të mirë në biznes dhe kërkimeve që cilësohen me mungesë të cilësisë profesionale. • Të ku[ptojë, përshkruajë, dhe shpjegojë natyrën e procesit kërkimor. • Të hartojë projekte kërkimore dhe zhvillojë ide mbi përfitimet për organizatën. • Të përshpejtojë qarkullimin e informacionit nëorganizatë dhe të kultivoj format e përshtatshme të komunikimit të të gjeturave nga kërkimet në biznes. • Të hartojë, komentojë dhe analizojë raportet nga kërkimet e zbatuara dhe të implementojë ato; • Të dëshmojë aftësi profesionale dhe përgatitje akademike nëmënyrë që të sigurojë mbijetesë në tregun e ashpër të punës;		
Rezultatet e prituratënxënies:	1. Aplikimi i njohurive themelore për kultivimin e aftësive kërkimore, organizuese dhe menaxheriale. 2. Zbatimi i Teknikave Hulumtuese me karakter shkencorë gjatë shkrimit të diplomës 3. Përdorimi i metodave dhe teknikave të moderuara për një hulumtim shkencor në biznes dhe organizim efektivtë atij procesi në praktikë. 4. Identifikimi i metodave dhe teknikave të duhurakërkimore dhe aplikimi i tyre nërastin konkret në praktikë, sidomos gjate Shkrimit të diplomes. 5. Këshillimi dhe puna ekipore në projekte kërkimore		
Kontributinëgarkesën e studentit (gjëqëduhettëkorrespondoj me rezultatet e tënxënitëstudentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Detyra shtëpie	1	5	5
Kolokviume	2.5	2	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	10	10
Koha e studimit vetanak të	2	10	20

studentit			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjerata gruporee shoqëruar me diskutime dhe teste vëmendshmërie, konsultime grupore dhe individuale, ushtrime, raste studimi dhe hulumtime, punime seminarike, detyra		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë: ✓ Të vijueshmërisë angazhimit dhe interaktivitetit gjate ligjeratave dhe ushtrimeve, ✓ Punimi hulumtues dhe puna praktike ✓ Moster e punimit të diplomës ✓ suksesit në kollokviume si dhe ✓ provimit përfundimtar.		
Literatura			
Literaturabazë:	1. Govori, Fadil, 2012: Metodat e hulumtimit shkencor në biznes, Botimi i parë,IFM, Prishtinë 2. "Guide to the successful Thesis and Disertation", a handbook for Student and Faculty, fifth edition, James E. Mauch, University of Pittsburgh.Namgi Park, Kwangju National University of Education, Republic Of Korea, 2003 3. Cooper, Donald R. & Pamela S. Schindler, 2011:Business Research Methods, 11 edition, McGraw-Hill/Irwin. 4. Saunders, Mark, 2009:Research methods for business students, Pearson Education Limited. 5. Babin, Barry J., Jon C. Carr and Mitch Griffin, 2009:Business Research Methods, 8th Edition, South-Western		
Literaturashtesë:	1. Woodside, Arch G., 2010: CASE STUDY RESEARCH: Theory, Methods, Practice, First edition, Emerald Group Publishing Limited. 2. Cozby, Paul C., Scott Bates. 2012: Methods in behavioral research, 11th ed. Published by McGraw-Hill. 3. Keegan, Sheila. 2009: Qualitative research : Good decision making through understanding people, cultures and markets, First Ed., Kogan Page Limited.		

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftim me planin mësimor, literaturën, provimet e pjesëshme, provimin final. Metodat kërkimore në biznes dhe Etika në kërkimet në biznes
Java e dytë:	Formulimi i hipotezës kërkimore dhe Procesi i kërkimeve në biznes: Një përmbledhje
Java e tretë:	Qartësimi i pyetjes kërkimore nëpërmjet hulumtimit të të dhënave dytësore dhe eksplorimit Dizajnimi i kërkimeve: Vështrim i përgjithshëm
Java e katërt:	Hulumtimi kualitativ- Procesi i Propozimit të Temës së Diplomës
Java e pestë:	Studimet e bazuara në vrojtime -Eksperimentet -Sondazhet - Matjet
Java e gjashtë:	Mbledhja e të dhënave –Pyetësorët - Intervistat - Grupet e fokusit
Java e shtatë:	Testi I
Java e tetë:	Analiza e të dhënave - Analiza statistikore
Java e nëntë:	Çështjet Administrative dhe Teknike dhe Rregullat e përpilimit të Temës së Diplomës
Java e dhjetë:	Forma e Evaluimit të Temës së Diplomës
Java e njëmbëdhjetë:	Testimi i hipotezës
Java e dymbëdhjetë:	Teoria e bazuar - Përdorimi i kompjuterëve në analizimin e të dhënave
Java e trembëdhjetë:	Rekomandimi i Formatit për mbajtjen e shënimeve – Footnotat/referencat etj
Java e katërbëdhjetë:	Të shkruarit për hulumtimin shkencor: Paraqitja e të gjeturave
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në ligjëratat, ushtrime, teste dhe provime;
- Ju duhet të bëni përpjekje të vetëdijshme dhe të vazhdueshme për të marrë pjesë në çdo orë dhe në mënyrë aktive të merrni pjesë në diskutime. Ju lutem vini re se thjesht "vetëm të merrni pjesë" në klasë nuk është e mjaftueshme;
- Të gjithë studentët pritet të sjellen në mënyrë profesionale. Sjelljet joprofesionale të tilla si, por pa u kufizuar vetëm në ato, përçarje të përsëritura të orës (duke përfshirë zakonisht, duke ecur në klasë, pasi ka filluar ora), duke fjetur në klasë, biseda të shpeshta me studentët e tjerë, apo vrazhdësi ndaj çdo personi, do të konsiderohet një çështje serioze shkelje dhe do të ndikojë në vlerësimin tuaj në fund të semestrit;
- Gjithashtu, është e rëndësishmja, TI ÇKYÇNI telefonat celularë para se të hyni në klasë. Telefonat celularë nuk mund të përdoren në testet si një kalkulator;
- Ndalohet rreptësisht përdorimi i celularit gjatë orës së mësimi dhe ushtrimeve e në veçanti gjatë provimeve të pjesëshme apo finale.